




Observatori për të Drejtat e Fëmijëve

**Raport studimor
“Situata e fëmijëve rom” për vitin 2012 - Qarku Fier**



QARKU FIER

Eksperte Rajonale
Eridjona Kica
Prill 2014

Lista e shkurtimeve

| | |
|--------|--|
| ODF | - Observatori për të Drejtat e Fëmijëve |
| UNICEF | - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë |
| UNDP | - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| CESS | - Qendra për Studime sociale dhe Ekonomike |
| NJDF | - Njësia për të Drejtat e fëmijëve |
| NJMF | - Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve |
| MAS | - Ministria e Arsimit dhe e Sportit |
| DAR | - Drejtoria Arsimore Rajonale |
| ZA | - Zyra Arsimore |
| DSHPSH | - Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore |
| SHSSH | - Shërbimi Social Shtetëror |
| MB | - Ministria e Brendshme |
| VKM | - Vendim i Këshillit të Ministrave |
| GTÇR | - Grupi Teknik për Çështjen e Romëve |
| NE | - Ndihmë Ekonomike |
| AK | - Aftësi e Kufizuar |

I. Parathënie dhe falënderime

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve është një organizatë jofitimprurëse, e cila nën mbështetjen financiare të UNICEF ka si realizuar qëllimin kryesor të ngritjes së një mekanizmi për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajonal dhe kombëtar. Zyra e Observatorit harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e treguesve të ndarë në sektorë të ndryshëm. Në rajonin e Fierit, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që në Shtator të vitit 2011.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Fier ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh publikë dhe jopublikë. Observatori Fier ka ngritur rrugën e bashkëpunimit me 57 aktorë të rëndësishëm publikë, si: Prefektura, Këshilli i Qarkut, bashkitë dhe komunat, institucionet shëndetësore, arsimore, të shërbimeve sociale, të policisë, të punësimit. Gjithashtu bashkëpunimi është shtrirë edhe me strukturat e shoqërisë civile.

Përveç mbledhjes së treguesve për të drejtat e fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si: arsim, shëndetësi, punësim, ndihmë ekonomike, pjesëmarrje e fëmijëve, Observatori Fier ka realizuar studimin rajonal me temë “Buxheti për fëmijët” në vitin 2011. Gjithashtu Observatori Fier realizoi edhe studimin rajonal me temë: “Situata e fëmijëve rom” për vitin 2012 në qarkun Fier.

Observatori Fier dhe Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore e Këshillit të Qarkut – Fier përgjatë periudhës Maj- Korrik 2013 kanë kontribuar në informimin e kapaciteteve institucionale për Kuadrin ligjor dhe institucional për zbatimin e politikave të përfshirjes sociale të hartuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Prej Shtatorit të vitit 2012, në kuadër të projektit “*Forcimi i Shërbimeve të Mirëqenies Sociale të Fëmijëve në nivel rajonal, në përgjigje të implementimit të politikës së përjashtimit social të fëmijëve – RIDE*”, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve- Fier bashkëpunon me Njësinë për të Drejtat e Fëmijëve- Fier. Qëllimi i bashkëpunimit është koordinimi dhe lehtësimi i kontakteve me të gjithë strukturat e mirëqenies sociale në nivel rajonal dhe lokal, për t’u siguruar se asnjë fëmijë nuk përjashtohet nga gëzimi i të drejtave të tyre. Kjo inisiativë ka ndihmuar në ngritjen e një strukture të integruar dhe koordinuar që mundëson përkujdesin social dhe shërbimet e mbrojtjes sociale.

Prej Nëntorit të vitit 2013, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve kontribuon në qarkun Fier në projektin kombëtar, që mbështetet nga UNICEF “*Çdo fëmijë rom në kopsht: Ndërtimi i rrjeteve të advokimit dhe praktikave të sukseshme në integrimin e fëmijëve rom*”.

Për realizimin e këtij studimi: “*Situata e fëmijëve rom në qarkun Fier*”, falenderoj për bashkëpunimin institucional dhe mbështetjen e tyre aktorët e rëndësishëm vendorë, si: Këshilli i Qarkut Fier (Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore- DSHPSH veçanërisht Z. Astrit Hysi dhe Njësia për të Drejtat e Fëmijëve NJDF Znj. Enerjeta Avrami), institucionet arsimore, shëndetësore, Shërbimin Social Shtetëror zyrën rajonale Fier. Një mirënjohje dhe një falenderim i veçantë i shkon kryetarëve të gjitha njësive vendore në qarkun Fier si edhe administratorëve social, punonjësve të ndihmës ekonomike dhe politikave sociale, punonjësve të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, që kanë dhënë kontributin e tyre nëpërmjet informacioneve të dërguara në mënyrë zyrtare.

ODF Fier shpreh mirënjohjen për një numër anëtarësh të komunitetit rom dhe egjiptianë, të cilët kontribuan në pasurimin e këtij studimi. Falenderoj punonjësit/et e Qendrave Shëndetësore/ Ambulancave të zonave ku ka komunitet rom, që dhanë informacione dhe shprehën këndvështrimin e tyre.

Një falënderim i veçantë i dedikohet UNICEF, që është mbështetja financiare për realizimin e këtij studimi. Mbështetja më e madhe profesionale ka ardhur nga Znj. Elma Tërshana (Drejtoreshë ekzekutive e projektit), Znj. Mina Mata (Administratore kombëtare e të dhënave) dhe stafi i zyrës qendrore të ODF Tiranë.

Falenderime të përzemërta!

II. Hyrja

Raporti “Situata e fëmijëve rom” është një studim, i cili është i rëndësishëm për rajonin e Fierit për shkak të numrit të lartë të këtij komuniteti në këtë qark. Shqipëria shprehu dëshirën për t’iu bashkuar Dekadës Rome në vitin 2007 dhe u bë anëtare me të drejta të plota e Dekadës me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr.437, datë 08.04.2008¹. Iniciativa e Dekadës përfshin periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2015. Në kuadër të antarësimit të Shqipërisë në Dekadën Rome, ka filluar edhe implementimi i Planit të Veprimit për Dekadën Rome, i cili fokusohet në 4 shtylla kryesore: arsim, shëndetësi, strehim dhe punësim si dhe në dy fusha prioritare kombëtare: Përfshirja sociale si dhe Mundësitë e barabarta; dhe Trashëgimia kulturore². Ecuria e këtyre katër komponentëve ka një rëndësi tejet të veçantë për t’u studiuar. Dekada e Përfshirjes së Romëve 2005-2015, që është iniciativa më e plotë për përmirësimin e jetës së romëve, vë një theks të veçantë në arsimimin e fëmijëve rom si një nga rrugët kryesore të integritit social të tyre.

Qëllimi i studimit është analizimi i ecurisë (progresit, qendrimit në vend apo regresit) së situatës së aksesit të fëmijëve rom në sektorët: mbrojtje sociale, shëndetësi, arsim dhe pjesëmarrje. Studimi analizon situatën e fëmijëve të komunitetit rom në vitin 2012 në qarkun Fier si edhe bën krahasimin brenda dhe jashtë komunitetit në dy rrethet e qarkut Fier (Fier dhe Lushnje) në të cilat gjendet ky komunitet. Situata e fëmijëve të komunitetit rom është adresuar në këtë studim për shkak të specifikave të këtij rajoni, i cili në përbërje të tij ka shumë kategori vulnerabël dhe të marxhinalizuara, të cilat bëhen objekt i përjashtimeve nga shërbimet e mirëqënies sociale. Gjithashtu ky studim është realizuar për shkak se madhësia dhe shtrirja e fenomenit janë gjithnjë e në rritje.

Fëmijët e komunitetit rom janë një kategori, që kërkon vëmendje të veçantë nga autoritetet e pushtetit qendror/ vendor, institucioneve publike dhe jopublike, në mënyrë që investimet, programet dhe shërbimet e ofruara ndaj tyre të jenë efektive dhe të dobishme.

Ky studim është bazuar në disa **burime informacioni**, të cilat janë:

- Të dhënat sasiore nga raporte dhe studime kombëtare për komunitetin rom;
- Të dhënat sasiore mbi lokalitetin, shtrirjen e këtij komuniteti nga Hartëzimi i shërbimeve nga Qendra për studime sociale dhe ekonomike dhe UNICEF 2011;
- Të dhënat sasiore nëpërmjet institucioneve për vitin 2012 në rajonin Fier, si: SHSSH zyra rajonale Fier, DAR, DSHP, QSH etj.
- Të dhënat sasiore nga qeverisja vendore, si: Këshilli i Qarkut Fier, Bashkitë/ Komunitatet ku ka komunitet rom;
- Të dhënat sasiore dhe cilësore nga sektori i shoqërisë civile (Shoqatat e komunitetit rom në rrethin Fier dhe Lushnje).

Ky studim i dedikohet një audience të gjerë, pasi gjetjet e këtij studimi i shërbejnë institucioneve publike dhe jopublike, institucioneve arsimore, shëndetësore, të mbrojtjes

¹ “Plani Vendor i Veprimit i Bashkisë Lezhë për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2013-2015”, fq 7.

² Dekada e Përfshirjes së Romëve, Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015, fq 4.

sociale, të punësimit, njësisive vendore që kanë në përbërje të tyre pjesëtar të këtij komuniteti, familjeve dhe vetë fëmijëve rom. Nëpërmjet gjetjeve të këtij studimi, njësitë vendore njihen me shtrirjen e problemeve më thelbësore që shoqërojnë jetën e fëmijët rom. Një fakt i tillë duhet të ndikoj në mirëpërcaktimin e fondeve buxhetore të cilat duhet të përfshijnë prioritetet e nevojave të fëmijëve rom.

Studimi i gjendjes së fëmijëve rom është një çështje e rëndësishme për të gjithë institucionet publike, jopublike dhe shoqërinë civile. Rezultatet e këtij studimi do i shërbejnë jo vetëm aktorëve të përfshirë në këtë studim, por të gjithë institucioneve që veprojnë në fushën e shërbimeve të mirëqënies sociale.

Ky studim ka në fokus të tij si grup kryesor *fëmijët e komunitetit rom*, (mosha 0-18 vjeç). Qarku Fier në vitin 2012 numëron një popullsi prej *489,457 banorë*³, nga të cilët rrethi Fier ka edhe numrin më të lartë të banorëve, duke u pasuar nga rrethi Lushnje dhe në fund nga rrethi i Mallakastrës. Ndërsa numri i fëmijëve (mosha 0-18 vjeç), në qarkun e Fierit për vitin 2012 është *126,092 fëmijë*, duke e renditur qarkun e Fierit në vendin e dytë në rang kombëtar me numrin më të lartë të fëmijëve, pas qarkut të Tiranës me *256,119 fëmijë*⁴. Numri i fëmijëve në qarkun Fier zë mbi ¼ e popullsisë në vitin 2012, konkretisht *25.76%*. Përqindjen më të lartë të numrit të fëmijëve e zë rrethi Mallakastër me *29.01%*, ndjekur nga rrethi Lushnje me *25.84%* dhe rrethi Fier me *25.18%*. Nëse do të krahasojmë tendencën e përqindjes së fëmijëve me vitin paraardhës, vërejmë një *rritje* (në vitin 2011 përqindja e fëmijëve në nivel rajonal në raport me popullsinë ishte *25%*).

Arsyeja e përzgjedhjes së studimit të gjendjes së fëmijëve rom në rajonin Fier është se në përgjithësi fëmijët zënë një numër të konsiderueshëm në qarkun Fier. Gjithashtu komuniteti rom është i shtrirë në një masë shumë të gjerë në këtë qark (rreth 15% e këtij komuniteti në rang kombëtar është i përqëndruar në qarkun Fier⁵). Numri i lartë i komunitetit rom duhet të shërbej për marrjen më shumë në konsideratë të realizimit të nevojave të fëmijëve rom, duke rritur shkallën e investimeve për këtë kategori dhe duke shtuar politikatat në fokus të mirëqënies dhe interesit më të lartë të tyre.

Çështjet që ky studim do të adresojë janë:

- 1) Sektori i mbrojtjes sociale mbulon nevojat e fëmijëve të komunitetit rom në përputhje me nivelin e jetesës së tyre?
- 2) Bazuar në rrethanat e jetesës, a përfitojnë fëmijët e komunitetit rom shërbime të kujdesit shëndetësor?
- 3) Në cikle të ndryshme të sistemit arsimor, si paraqitet niveli i rregjistrimit dhe i frekuentimit të fëmijëve të komunitetit rom?
- 4) Si paraqitet shkalla e pjesëmarrjes dhe fuqizimit të fëmijëve të komunitetit rom në jetën sociale?

Përshkrimi i situatës së fëmijëve rom:

Për evidentimin e nevojave specifike të komunitetit rom shërben dokumenti zyrtar i Planit Kombëtar të Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome 2010- 2015. Ky Plan është një dokument i Qeverisë Shqiptare që u hartua në bashkëpunim me UNDP-në dhe përfaqëson kuadrin e aktiviteteve që synojnë integrimin e popullsisë rome në Shqipëri⁶. Sipas këtij Plani

³ Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

⁴ Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

⁵ Raport i veçantë nr 4 "Për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri".

⁶ Raport i veçantë nr 4 "Për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri", fq 8.

evidentohen prioritetet dhe nevojat thelbësore në 4 fusha të mirëqënies sociale: arsim, shëndetësi, strehim dhe punësim. Megjithatë secili qark, rreth, bashki/ komunë, fshat dhe lagje ka specifikat e veta të ndryshme për komunitetin rom.

Në Shqipëri është ngritur Sekretariati Teknik për Çështjet Rome në 10 qarqe të Shqipërisë (përveç Kukësit dhe Dibrës, që kanë një numër më të ulët të komunitetit rom në raport me qarqet e tjera). Ndërkohë në 12 qarqe është ngritur Komiteti i Vlerësimit të Nevojave dhe i Planifikimit të Shërbimeve. Ky Komitet përcakton dhe vlerëson:

- a) Numrin dhe llojet e shërbimeve që nevojiten;
- b) Ofruesit e mundshëm të shërbimeve shoqërore;
- c) Projektet e propozuara nga institucionet, OJF-të, donatorët apo biznesi shoqëror për ngritjen e shërbimeve të reja-komunitare⁷.

Në secilin qark është ngritur edhe Grupi Teknik për Çështjen e Romëve (GTÇR), i cili trajton çështjet prioritare dhe lehtëson aksesin e komunitetit rom për realizimin e nevojave të tyre. GTÇR ka si qëllim evidentimin e situatës social-ekonomike, vlerësimin sasior dhe cilësor të nevojave të komunitetit rom, grumbullimin e të dhënave statistikore, përdorimin e burimeve lokale për të siguruar një akses më të madh të këtij komuniteti për shërbimet e mirëqënies sociale që ofrohen në nivel qarku. Anëtarët e këtij grupi në Qarkun Fier janë në nivel specialisti për institucionet dhe në nivel drejtuesi/ koordinatori projekti nga Organizatat jo Fitimprurëse. Së shpejti pritet që nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë të ngrihet një VKM e posaçme për raportimin mbi treguesit e komunitetit rom nga ana e personave të trajnuar në grupet teknike⁸.

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale në rajonin Fier, përcaktohen objektivat kryesore dhe masat konkrete, që duhet të ndërmerren për të zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar ecurinë e progresit të kësaj Strategjie në rajon, drejt mbrojtjes dhe përfshirjes së grupeve të rrezikuara nga përjashtimi social.

Plani i Veprimeve për Integrimin e Fëmijëve Romë 0-6 vjeç (2012- 2016) në Qarkun Fier, përfshin:

- Identifikimin dhe menaxhimin e rasteve;
- Kujdesin shëndetësor;
- Shërbimet e kujdesit dhe zhvillimit.

Metodologjia

Për realizimin e studimit të gjendjes së fëmijëve të komunitetit rom në nivel rajonal, burimi i të dhënave ka konsistuar në metodologjinë:

- a) ***Desk review***, e cila përfshin rishikimin e dokumenteve, raporteve, ligjeve, studimeve kombëtare, disa prej të cilave janë:
 - Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom 2003;
 - Udhëzim nr. 06, datë 29.03.2006, “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje”.
 - Plani i Veprimit të Dekadës Rome 2010- 2015;
 - Sekretariati teknik i romëve si pjesë e Departamentit për Monitorimin e Strategjive;
 - Komiteti i Vlerësimit dhe i Planifikimit të Nevojave në Këshillin e Qarkut;
 - Grupi Teknik për Çështjet Rome.

⁷ VKM nr 563, datë 12.8.2005, “Për përcaktimin e përgjegjësive të qarkut dhe shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.

⁸ Blerina Zoto, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, 4 Dhjetor 2014

b) Mbledhje informacioni në lidhje me situatën e fëmijëve të komunitetit rom nga: Grupi Teknik për Çështjen Rome, Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore- Këshilli i Qarkut Fier, Shërbimi Social Shtetëror zyra rajonale Fier, Drejtoria Arsimore Rajonale Fier, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Fier/ dhe Lushnje. Ndërsa përgjatë muajve Nëntor- Dhjetor 2013 të gjitha njësitë vendore të qarkut Fier (që kanë dhe nuk kanë në përbërje të tyre komunitet rom), si edhe institucioneve të mirëqënies sociale në rajonin Fier, i është dërguar një shkresë zyrtare informuese mbi studimin rajonal. Bashkëlidhur shkresës është dërguar edhe një pyetësor mbi numrin dhe situatën e fëmijëve të komunitetit rom. (Në Fier: Komuna Qendër, Dërmenas, Levan, Topojë, Mbrostar, Bashkia Roskovec. Në Lushnje: Komuna Grabian, Tërbuf, Dushk, Golem, Bashkia Lushnje. Ndërsa në rrethin Mallakastër nuk ka komunitet rom. (Në *Shtojca b* gjenden njësitë vendore, fshatrat ku gjendet komuniteti rom në qarkun Fier).

Instrumentet e përdorura për realizimin e pyetësorit ishin pyetjet e mbyllura dhe të hapura. U shpërndanë 42 pyetësorë në njësitë vendore duke u lënë në dispozicion dhe një afat për marrjen e informacionit. (Në *Shtojca a* gjenden pyetjet e përdorura për mbledhjen e informacioneve nëpërmjet pyetësorëve).

c) Takimet me personat lider të komunitetit rom, si edhe me punonjës të komunave/ bashkive, edukatorët/ët e kopshteve, mjeket/ët e qendrave shëndetësore, që ndodhen në zonat që kanë në përbërje të tyre anëtarë të komunitetit rom. Këto takime u realizuan përgjatë muajve Dhjetor 2013- Janar 2014.

Gjatë kryerjes së studimit është garantuar **etika, konfidencialiteti dhe siguria** për përdorimin e të dhënave dhe materialeve për qëllimin e raportit studimor. Titullarët e institucioneve dhe administratorët social janë informuar për qëllimin e raportit studimor duke kërkuar nga ana e tyre të dhëna zyrtare, të cilat do të përdoren në një raport rajonal, i cili në fund do të publikohet.

Limitet/ kufizimet e studimit lidhen me afatin e shkurtër kohor për mbledhjen e informacionit, si edhe me mundësitë e kufizuara financiare që kushtëzuan mospjesëmarrjen e komunitetit rom nëpërmjet fokus grupeve. Të dhënat e mbledhura nga Institucionet përkatëse janë një burim i qëndrueshëm informacioni. Ndërsa fokus grupet pasqyrojnë gjendjen reale të shifrave në terren. Fokus grupet sjellin këndvështrimin e prindërve dhe fëmijëve të komunitetit rom për realizimin e nevojave më thelbësore.

Pritshmëritë nga studimi lidhen me analizën e situatës së integritetit të fëmijëve të komunitetit rom në fushat e mirëqënies sociale në qarkun Fier. Në këtë studim një rëndësi të veçantë ka përcjellja e shqetësimeve/ nevojave thelbësore dhe prioritare nga ana e punonjësve që punojnë në zonat ku është i përqendruar ky komunitet.

III. Analiza e të dhënave

Procedura për analizën e të dhënave

Pas përdorimit të metodologjisë nëpërmjet teknikës *Desk review*, mbledhjes së informacionit me formularin të plotësuar nga administratorët social/ punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësitë vendore dhe komunikimit nëpërmjet *takimeve*, për përpunimin e të dhënave u përdor një *analizë përshkruese (deskriptive) dhe krahasuese* e integritetit të fëmijëve të komunitetit rom në fushat e mirëqënies sociale:

- Mbrojtje sociale;
- Shëndetësi;
- Arsim;

- Pjesëmarrje.

Të drejtat e fëmijëve- një përgjegjësi e përbashkët

Të drejtat e fëmijëve janë të ligjëruara që nga ligji themelor i Shqipërisë (Kushtetuta) deri tek dokumentat strategjike, që kanë në fokus interesin më të lartë të fëmijës. Fëmijët e minoriteteve, pakicave kombëtare, grupeve më të marxhinalizuara, janë kategoritë që i cënohen më tepër të drejtat. Të drejtat e fëmijëve të komunitetit rom përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom të vitit 2003, e cila u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave⁹. Në këtë Strategji është përfshirë edhe një plan i detajuar me institucionet përgjegjëse si edhe buxheti i parashikuar për realizimin e këtyre objektivave për çdo vit duke filluar nga viti 2003 e në vazhdim.

Në qarkun Fier janë disa njësi vendore që kanë në përbërje të tyre komunitet rom. Këto njësi vendore i përkasin vetëm dy rretheve të qarkut Fier (rrethi Fier dhe rrethi Lushnje). Ndërkohë në rrethin Mallakastër nuk ka komunitet rom.

Tabela 1: Lista e Bashkive/ komunave/ fshatrave ku ka komunitet Rom në qarkun Fier.
Burimi: Obsevatori për të Drejtat e Fëmijëve Fier, Projekti “Çdo fëmijë rom në kopsht: Ndërtimi i rrjeteve të advokimit dhe praktikave të suksesshme në integrimin e fëmijëve rom”.

| Nr. | Njësia vendore |
|-----------------------|-------------------------------------|
| Rrethi Fier | |
| 1 | Komuna Qendër, Fshati Rom |
| 2 | Komuna Qendër, Fshati Fermë Çlirim |
| 3 | Komuna Dërmenas, Fshati Baltëz |
| 4 | Komuna Dërmenas, Fshati Povelçe |
| 5 | Komuna Levan |
| 6 | Komuna Topojë, Fshati Seman i ri |
| 7 | Bashkia Roskovec |
| 8 | Komuna Mbrostar, Ura |
| Rrethi Lushnje | |
| 1 | Komuna Grabian |
| 2 | Komuna Tërbuf, Fshati Çermë Sektor |
| 3 | Komuna Tërbuf, Fshati Shën e Premte |
| 4 | Komuna Dushk, Fshati Gramsh |
| 5 | Komuna Dushk, Fshati Zhamë |
| 6 | Komuna Golem, Fshati Plug |

⁹ Këshilli i Ministrave Nr.633, Fletore Zyrtare, 18 Shtator 2003.

Nga takimet e realizuara nga Observatori Fier, disa prej fshatrave të njësive vendore kanë në popullsinë e tyre vetëm komunitet rom, i cili jeton i veçuar nga pjesa tjetër e popullsisë (Fshati Rom në Komunën Qendër Fier, Lagja rome në Komunën Levan Fier). Ndërsa në disa fshatra të njësive vendore, komuniteti rom jeton i përzier me pjesën tjetër të popullsisë (Fshati Fermë Çlirim në Komunën Qendër Fier, Fshati Baltëz në Komunën Dërmenas Fier, Fshati Povelçe në Komunën Dërmenas Fier, Fshati Seman i ri në Komunën Topojë Fier, Bashkia Roskovec Fier, Komuna Mbrostar Ura Fier, Komuna Grabian Lushnje, Fshati Çermë Sektor dhe Shën e Premte në Komunën Tërbuf Lushnje, Fshati Gramsh dhe Zhamë në Komunën Dushk Lushnje, Fshati Plug në Komunën Golem Lushnje, Lagja Savër në Bashkinë Lushnje).

Përgjatë 5 viteve të fundit, UNDP ka investuar në Fier në:

- Rritjen e aksesit në shërbimet sociale përmes rregjistrimit civil;
- Mbështetjen e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrjen lokale;
- Zhvillimin e aftësive për punësim;
- Mobilizimin e mediatorëve komunitar në fushat e shëndetësisë dhe arsimit;
- Nxitjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Romët;
- Advokimin për çështjet e minoriteteve në nevojë dhe përfshirjen e tyre sociale.

Në këtë mënyrë, UNDP në Fier ka ngritur:

- Kopshtin në Fshatin Rom të Komunës Qendër Fier;
- Kopshtin në Komunën Mbrostar Ura Fier;
- Qendrën e Shërbimeve komunitare në Komunën Levan Fier.

Kopshti në fshatin Rom të Komunës Qendër Fier dhe Qendra e Shërbimeve komunitare në lagjen rome të Komunës Qendër Fier, janë ngritur dhe funksionojnë optimalisht në këto lokalitete për shkak se ka vetëm komunitet rom. Situata aktuale është se kopshti i ngritur në Komunën Mbrostar Fier_Ura, nuk funksionon për shkak se një banor i zonës vërteton pronësinë e tokës dhe është vendosur familjarisht në objektin që UNDP ka ndërtuar pasi është i pa strehë.

Profili i komunitetit rom

Komuniteti rom është konsideruar si komuniteti më i cënuar në Shqipëri, që përballet me varfëri të skajshme, marxhinalizim social-ekonomik dhe diskriminim të vazhdueshëm, në veçanti për të drejtën e arsimit, mbrojtjes sociale, kujdesit shëndetësor, punësimit dhe të strehimit të përshtatshëm¹⁰. Romët jetojnë në Shqipëri për më tepër se 600 vjet¹¹.

Të dhënat stastistikore lidhur me numrin e romëve që jetojnë në Shqipëri mungojnë¹². Ndërkohë të dhënat e para për popullsinë rome datojnë shumë herët. Pasqyrimi i tyre jepet nëpërmjet kësaj table:

Tabela 2: Numri i popullsisë rome ndër vite

¹⁰ Monitorimi nga shoqëria civile i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Dekadës Rome, 2012 në Shqipëri

¹¹ Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, 2003, fq 8.

¹² Raport studimor “Mbi situatën e romëve që jetojnë e punojnë në vendshkarkimin e mbeturinave në Sharrë”, fq 7.

Burimi: Raport Studimor ARSIS, FBSH, FPGSH.

| Viti | Numri i popullsisë rome |
|------|-------------------------|
| 1930 | 20 000 |
| 1980 | 62 000 |
| 1995 | 120 000 |

Janë identifikuar 2 grupe të popullsisë rome:

- Rom të qëndrueshëm (Egjiptian), të cilët janë identifikuar që në vitin 1300. Kjo kategori e ka më të lehtë të integrohet.
- Rom të lëvizshëm (Rom), të cilët e ruajnë më tepër traditën e tyre, ndaj e kanë më të vështirë të integrohen.

Disa nga probemet, të cilat prekin më tepër këtë komunitet janë:

- ü Punësimi- Lypja
- ü Të ardhurat ekonomike- Varfëria
- ü Arsimimi- Braktisja e shkollës
- ü Regjistrimi në gjendjen civile
- ü Trafikimi i vajzave dhe grave
- ü Martesat e vajzave rome në një moshë të vogël (13-14 vjeç)
- ü Shëndetësia- Pajisja me kartela mjekësore

Një në gjashtë fëmijë rom në Qarkun e Fierit është me aftësi të kufizuara¹³. Sipas të dhënave të mbledhura nga SHSSH zyra rajonale Fier, në Qarkun e Fierit jetojnë 6810 banorë, me një ndarje prej 1740 familjesh. Nga rreth 1000 fëmijë rom në total, 171 prej tyre janë me aftësi të kufizuara.

Sipas Mapping¹⁴ në të gjithë Shqipërinë janë identifikuar 14600 banorë rom, nga të cilët 40% janë fëmijë 0-18 vjeç, 4000 janë në moshë shkollore. Nga shifra totale e banorëve rom mendohet se 15 % e banorëve janë përjashtuar (familjet që kishin lëvizur dhe nuk ishin në Shqipëri, familjet që refuzonin të anketoheshin), ndërsa pjesa tjetër 14600 banorë janë identifikuar. Ndërkohë Census ka identifikuar 8300 banorë rom, numër shumë më i vogël në krahasim me gjetjet e studimit të hartëzimit.

Perceptimi popullor mbi numrin e komunitetit rom dhe egjiptian është larg realitetit. Psh: egjiptianët shprehen se janë 350 mijë banorë, ndërsa romët thonë se janë 150 mijë. Pra perceptimi i tyre është së janë 0.5 milion banorë nga 1.8 milionë banorë që jetojnë në Shqipëri. Ndërkohë sipas të gjitha të dhënave publike për këtë komunitet (rom+ egjiptian), kjo shifër varion nga 20 mijë- 150 mijë banorë¹⁵, pa llogaritur banorët emigrues.

Të dy komunitetet rome dhe egjiptiane përballen në mënyrë të vazhdueshme me përjashtimin social. Evidentohet se komuniteti egjiptianë është më i integruar në jetën shoqërore në krahasim me komunitetin rom. Konkretisht në fshatin Kocaj të Komunës Fiershegan në Lushnje jetojnë 24 banorë (4 familje) të komunitetit egjiptianë, të cilat janë shumë të integruar në jetën shoqërore¹⁶. Fëmijët e këtyre familjeve frekuentojnë rregullisht ciklet e ndryshme të sistemit arsimor. Në këto familje janë 9 fëmijë të moshës 0-18 vjeç, nga të cilët;

- 2 ndjekin arsimin parashkollor (mosha 3-6 vjeç)

¹³ Të dhëna nga Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier, Prill 2012

¹⁴ CESS Mapping Roma Children in Albania, 2012

¹⁵ Raport i veçantë nr 4 "Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri",

¹⁶ Të dhënat janë mbledhur nga punonjësja e NJMF në Komunën Fiershegan Lushnje, Dhjetor 2013

- 5 ndjekin arsimin e detyruar 9-vjeçar (mosha 6-15 vjeç);
- 2 ndjekin arsimin e mesëm (mosha 15-18 vjeç).

Grafikë 1: Përqindja e fëmijëve egjiptiane në fshtain Kocaj të Komunës Fiershegan Lushnje të ndarë sipas cikleve të arsimit (ku 9 fëmijë në total=100% e regjistrimit)

Burimi: NJMF e Komunës Fiershegan Lushnje, Dhjetor 2013.



Në këtë fshat, këto familje egjiptiane janë në gjendje e mirë ekonomike. Ato nuk trajtohen me ndihmë ekonomike, kanë banesa të rregullta si banorët e tjerë të Komunës Fiershegan. Gjendja e tyre mjekësore paraqitet e mirë, janë të vaksinuar dhe të pajisur me kartela mjekësore.

Romët dhe egjiptianët në Shqipëri, nën ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë, kanë patur një rritje më të madhe të popullsisë në krahasim me popullsinë e maxhorancës¹⁷. Popullsia rome në një pjesë të madhe nuk figuron e regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, fenomen i cili është më i përhapur për personat e lindur pas viteve '90¹⁸. Vajzat martohen në një moshë më të re dhe bëhen nëna më shpejt se grupet e tjera etnike.

Edukimi parashkollor është i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm për arsimimin e fëmijëve. Fëmijët që më parë kanë frekuentuar kopshtin përshtaten më mirë me mjedisin e shkollës, kur shkojnë në shkollën fillore, dhe kanë më pak vështirësi në përvetësimin e mësimëve. Përfshirja e të gjithë fëmijëve në sistemin parashkollor, që duhet të jetë i detyrueshëm për të gjitha familjet, duhet të jetë një nga prioritetet në politikat arsimore. Në zonat që kanë vetëm komunitet rom (si: Fshati Rom_Komuna Dërmenas Fier. Lagja rome në Levan Fier), kopshtet përbëhen vetëm nga fëmijë rom, ndërsa në zonat e tjera fëmijët rom frekuentojnë të njëjtin kopsht me fëmijët e tjerë.

Të dhënat për popullsinë rome dhe egjiptiane në qarkun Fier nuk janë të mbledhura në ndonjë institucion publik. Disa evidenca mblidhen me përafërsi nga disa projekte të shoqërisë civile. Duke shtuar faktin se komuniteti rom karakterizohet nga të qënurit “lëvizës”, evidencat lidhur me gjendjen e komunitetit rom kanë luhatur të mëdha shifrash nga njëri burim në tjetrin. Duke i'u referuar vlerësimit të bërë nga UNICEF mbi vendndodhjen e popullsisë rome dhe egjiptiane në rang kombëtar¹⁹, rezultojnë se në total në qarkun Fier janë 2369 banorë të këtij

¹⁷ “Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri”, 2012, UNDP, fq 13.

¹⁸ Raport i veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri”, fq 2.

¹⁹ www.sidalbania.org

komuniteti, nga e cila 1 711 banorë i përkasin rrethit Fier ndërsa 658 banorë i përkasin rrethit Lushnje.

Grafikë 2: Përqindja e banorëve të komunitetit rom në rrethin Fier dhe Lushnje
Burimi: www.sidalbania.org



IV - Analiza e studimit

Mbrojtja sociale

Komuniteti rom dhe egjiptianë përballet me probleme nga më të ndryshmet. Pothuajse të gjitha problemet kanë si bosht qëndror çështjen ekonomike si: të ardhurat e ulëta. Problemet ekonomike ndikojnë ndjeshëm në mënyrën e jetesës së këtij komuniteti. Në kushte tejet të vështira deri në skamje, shumë prindër i shfrytëzojnë fëmijët e tyre me lypje, shitje në rrugë, mbledhje kanaçesh etj.

Një realitet i tillë, i përjashton këta fëmijë nga shumë shërbime të mirëqënies sociale. Fëmijët të cilët punojnë në ditët dhe orët mësimore, privohen nga sistemi arsimor. Kjo gjendje përsëritet në një rreth ciklik, në të cilën varfëria sjell varfëri. Duke marrë në konsideratë të ardhurat e ulëta, si edhe numrin e lartë të pjesëtarëve të një familjeje, gjendja vështirësohet edhe më shumë. Skema e ndihmës ekonomike trajton një numër të kufizuar familjesh.

Trajtimi i fëmijëve rom me ndihmë ekonomike

Përgjatë vitit 2012, nga skema e ndihmës ekonomike kanë përfituar 3409 familje me fëmijë 0-18 vjeç²⁰.

Nga të dhënat evidentohet se në disa njësi vendore, që kanë një numër të konsiderueshëm të popullsisë rome, familjet e këtij komuniteti nuk trajtohen me ndihmë ekonomike. Këto njësi vendore në rrethin Fier janë:

- Bashkia Roskovec
- Komuna Dërmenas
- Komuna Mbrostar (e cila është e përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike)
- Komuna Topojë (e cila është e përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike)
- Komuna Levan

Ndërsa njësitë vendore në rrethin Lushnje janë:

²⁰ Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier, Evidencat Dhjetor 2012

- Komuna Grabian
- Komuna Tërbuf
- Komuna Fiershegan

Nga përfituesit në total nga skema e ndihmës ekonomike, janë 74 familje rome përfituese, nga të cilat:

Tabela 3: Numri i familjeve rome që përfitojnë Ndihmë Ekonomike, viti 2012
Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier, Evidencat Dhjetor 2012

| Njësitë vendore | Familjet rome në NE me fëmijë 0-6 vjeç | Familjet rome në NE me fëmijë 6-15 vjeç | Familjet rome në NE me fëmijë 0-15 vjeç | Familjet rome në NE me fëmijë 15-18 vjeç | Familjet rome në NE me fëmijë 0-18 vjeç |
|-------------------------------------|--|---|---|--|---|
| | a | b | c= a+b | d | e= c+d |
| Totali i Rrethit Fier | 35 | 33 | 68 | 19 | 87 |
| Komuna Qendër | 35 | 33 | 68 | 19 | 87 |
| Totali i Rrethit Lushnje | 10 | 11 | 21 | 10 | 31 |
| Bashkia Lushnje | 2 | 1 | 3 | 1 | 4 |
| Komuna Golem | 7 | 9 | 16 | 9 | 25 |
| Komuna Dushk | 1 | 1 | 2 | 0 | 2 |
| Totali i Rrethit Mallakastër | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali i Qarkut Fier | 45 | 44 | 89 | 29 | 118 |

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelë numri më i lartë i familjeve përfituese nga skema e ndihmës ekonomike janë ato me fëmijë 0-6 vjeç (45 familje në nivel qarku), ndërsa numri më i lartë i takon familjeve rome me fëmijë mbi 15 vjeç (29 familje).

Familjet rome që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike zenë 3.46% të familjeve në total (118 familje rome përfitojnë NE nga 3409 familje në total).

Tabela 4: Përqindja e familjeve që trajtohen me Ndihmë Ekonomike sipas grupmoshave, viti 2012

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier, Evidencat Dhjetor 2012

| | Familjet në NE me fëmijë 0-6 vjeç | Familjet në NE me fëmijë 6-15 vjeç | Familjet në NE me fëmijë 15-18 vjeç | Familjet në NE me fëmijë 0-18 vjeç |
|--|-----------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|
| | | | | |

| | | | | |
|----------------------------|--------|--------|--------|--------|
| Familjet Komunitetit rom e | 5.21% | 2.88% | 2.84% | 3.46% |
| Familjet e tjera | 94.79% | 97.12% | 97.16% | 96.54% |

Në krahasim me vitin 2011, numri i familjeve rome që marrin Ndihmë ekonomike më fëmijë 0-18 vjeç ka ardhur **duke u rritur** me 9 familje nga 109 familje në vitin 2011 në 118 familje në vitin 2012.

Një ndër problemet më thelbësore të komunitetit rom në qarkun Fier lidhet me *mosrregjistrimin e tyre në gjendjen civile*. Neni 7 i “Konventës për të Drejtat e Fëmijës” parashikon që fëmijët kanë të drejtë të kenë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi²¹. Arsytet e mosrregjistrimit janë nga më të ndryshme.

Nëpërmjet ndryshimeve të fundit në ligjin nr.10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, sikurse edhe në Udhëzimin nr.7, datë 10.1.2012 “Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve, që do të plotësohen nga përfaqësues të policisë së shtetit dhe të njësive bashkiake/komunave, për rastet e fëmijëve të gjetur dhe të fëmijëve të parregjistruar në gjendjen civile”, janë lehtësuar ndjeshëm procedurat për rregjistrimin civil. Nëpërmjet këtyre lehtësirave të krijuara, praktikisht asnjë fëmijë nuk mbetet pa rregjistruar. Observatori Fier në kuadër të nismës “*Forcimi i Shërbimeve të Mirëqenies Sociale të Fëmijëve në nivel rajonal, në përgjigje të implementimit të politikës së përjashtimit social të fëmijëve – RIDE*”, ka koordinuar bashkëpunimin institucional për zgjidhjen e rasteve të fëmijëve të parregjistruar në gjendjen civile.

Mirëpo ka disa arsye që çojnë në mosrregjistrimin në gjendjen civile të fëmijëve të komunitetit rom, si:

- ü Mentaliteti i prindërve
- ü Mungesa e informacionit mbi mënyrat e rregjistrimit dhe përfitimet nga shërbimet e mirëqenies sociale pas rregjistrimit
- ü Mungesat në dokumentacion/ vërtetimet e lindjes si certifikata e asistencës së lindjes
- ü Martesat në moshë të hershme, që për shkak të moshës nuk celebren
- ü Neglizhenca për arsye subjektive

Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët e gjendur në këto rrethana nuk kanë mundësi që të përfitojnë nga të drejtat e tyre të garantuara edhe të parashikuara në Konventë si: arsimim dhe shërbimet shëndetësore. Gjithashtu këta fëmijë nuk përfshihen në sistemin e të dhënave, për rrjedhojë nuk bëhen pjesë e monitorimit të ecurisë dhe të hartimit të programeve të ardhshme. Mosrregjistrimi civil i fëmijëve i përjashton ata edhe nga gëzimi i të drejtave të tjera thelbësore, si: e drejta e njohjes.

Kujdesi Shëndetësor

Nga takimet me mjeket/ët dhe infermieret/ët e Qendrave Shëndetësore/ Ambulancave²² në njësitë vendore ku ka komunitet rom, është evidentuar se shumica e këtyre banorëve, nuk kanë një vëmendje të veçantë për shërbimet shëndetësore. Nga një fakt i tillë më të prekur janë edhe fëmijët. Në Ambulancën Hamil të fshatit Baltëz në Komunën Dërmenas Fier,

²¹ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, fq 4


²² Takimet e realizuara në Qendra Shëndetësore/ Ambulancat në muajt Dhjetor 2013- Janar 2014

mjekja deklaroi se familjet e komunitetit rom neglizhojnë marrjen e librezave të shëndetit, të cilat kushtojnë fare pak²³. Sipas të dhënave në këtë Ambulancë janë vetëm 10 gra rome që marrin pjesë në planifikimin familjar. Mungesa e ndjeshmërisë së komunitetit rom ndaj shërbimeve shëndetësore lidhet edhe me nivelin e ulët arsimor/ edukues.

Mungesa e rregjistrimit në gjendjen civile të komunitetit rom, i përjashton nga përfitimi i librezave shëndetësore. Në mungesë të librezave shëndetësore shumë prindër të komunitetit rom kërkojnë shërbim shëndetësor për fëmijët e tyre kur sëmundja ka kaluar në një stad të avancuar.

Sipas të dhënave të ofruara nga Ambulanca e fshatit Seman i ri, janë 26 fëmijë rom të moshës 0-14 vjeç dhe të 26 fëmijët rom janë të pajisur me kartela mjekësore. Ndërkohë nga takimi me maminë e Ambulancës asnjë nga fëmijët e komunitetit rom nuk kanë librezë shëndetësore.

Grafikë 3: Numri i fëmijëve të komunitetit rom në fshatin Seman i ri, Komuna Topojë Fier
Burimi: Ambulanca e fshatit Seman i ri, 10 Janar 2014



Ndërkohë përveç pajisjes me librezë shëndetësore, një problem paraqet edhe vaksinimi i fëmijëve të komunitetit rom, i cili jepet falas. Vaksinimi është një proces i vështirë te familjet e mëdha që jetojnë në fise. Vaksinimi për *fëmijët e komunitetit rom* në fshatin Seman i ri në Komunën Topojë Fier rezulton në masën 100 %.²⁴

Sëmundjet nga të cilat preken më tepër fëmijët e komunitetit rom janë: dermatoza (sëmundjet e lëkurës, infeksionet urinare, cistitet, sëmundja e zgjebes, tiroidet etj).²⁵

E drejta për Arsim

Në Shqipëri mungojnë të dhënat e plota dhe të sakta për arsimimin e popullsisë rome dhe në veçanti, për fëmijët romë që vijnë nga censuset zyrtare²⁶. Rregjistrimi dhe frekuentimi i fëmijëve rom në cikle të ndryshme arsimore është në fokus të dokumentave kryesorë

²³ Takim me mjeken e Ambulancës Hamil në fshatin Baltëz Dërmenas, 18 Dhjetor 2013

²⁴ Takim me maminë e Ambulancës Seman i ri në Komunën Topojë Fier, 10 Janar 2014.

²⁵ Takim me mjeken e Ambulancës Zhamë në Komunën Dushk Lushnje, 29 Janar 2014

²⁶ Raport studimor: "Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri", fq 10.

strategjikë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. Nga takimi i realizuar në fshatin Seman i ri Komuna Topojë, në të cilën ka komunitet rom, shkalla e regjistrimit të totalit të fëmijëve rom në ciklet arsimore paraqitet e tillë:

Tabela 7: Shkalla e regjistrimit të fëmijëve rom në ciklet arsimore në disa njësi vendore
Burimi: Takimi në fshatin Seman i ri Komuna Topojë 10 Janar 2014. Përlllogaritja në përqindje e shkallës së regjistrimit në ciklet e ndryshme arsimore është realizuar nga Observatori Fier.

| Janar 2014 | Gjithsej fëmijë 0-14 vjeç | Numri i fëmijëve në edukim | Përqindje |
|--|---------------------------|----------------------------|-----------|
| Komuniteti rom (Komuna Topojë_Fshati Seman i ri) | 26 | 14 | 53.8% |

Romët janë ndër komunitetet me nivelin më të ulët arsimor në Shqipëri²⁷. Në të tre ciklet e ndryshme arsimore (parashkollor, i detyruar 9-vjeçar, i mesëm) evidentohet një nivel i ulët i regjistrimit, e për më tepër i frekuentimit. Në shkollën 9- vjeçare Llukan Sako në fshatin Seman i ri, asnjë nga fëmijët e komunitetit rom që përfundojnë arsimin e detyruar nuk ndjek arsimin e mesëm²⁸.

Shkaqet e shkallës së ulët të regjistrimit të fëmijëve të komunitetit rom në arsim janë: mentaliteti, gjendja e vështirë ekonomike, përfshirja në punë të ndryshme, martesat në moshë të hershme tek vajzat (13-14 vjeç), diskriminimi dhe paragjykimi nga fëmijët e maxhorancës, vështirësitë gjuhësore, migrimi dhe emigrimi etj. Të gjithë këta faktorë kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e shkallës së braktisjes së shkollës.

Në disa njësi vendore, në të cilat komuniteti rom është i integruar, evidentohet edhe një performancë e lartë mësimore e fëmijëve rom. Në këtë mënyrë një vajzë e këtij komuniteti, e cila është pjesë e këndit të krenarisë së shkollës, gjatë orës mësimore ka shkruar këtë letër për shoqen e saj që i përket maxhorancës:

E dashur Julia

Ti edhe shoqet e tjera më keni mbështetur dhe më keni mbajtur afër, më keni mësuar disa gjëra që unë s'i kuptoja me në krye mësuësen tonë të dashur Mirela. Edhe unë shoqja juaj Anisa ju dua, ju respektoj shumë. Ditën e parë që erdha unë u kënaqa pa masë. Ju dua shumë Anisa.

Nxënëse e shkollës 9-vjeçare Llukan Sako në fshatin Seman i ri, Topojë Fier, 10 Janar 2014

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare "Për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Romëve", me gjithë përpjekjet e vazhdueshme, ende ka fëmijë rom që nuk frekuentojnë shkollën për shkaqe të ndryshme, si: mos regjistrimi në gjendjen civile, mungesa e çertifikatës së lindjes etj. Për rrjedhojë Ministria e Arsimit ka krijuar lehtësira për rritjen e shkallës së regjistrimit të fëmijëve rom në arsim. Drejtoritë e shkollave hapin një regjistër të veçantë dhe bëjnë regjistrimin në shkollë të fëmijëve rom që nuk kanë çertifikatë lindje.²⁹

²⁷ Monitorimi nga shoqëria civile i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Dekadës Rome, 2012 në Shqipëri

²⁸ Takim me drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare Llukan Sako, fshati Seman i ri, Komuna Topojë Fier, 10 Janar 2014.

²⁹ Udhëzim nr. 06, datë 29.03.2006, "Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje".

DAR Fier zbaton një Plan vjetor të veprimit për fëmijët rom, në të cilin janë planifikuar aktivitetet për fëmijët e komunitetit rom dhe afatet kohore të realizimit të tyre (Ky plan gjendet në Shtojca c).

Pjesëmarrja dhe fuqizimi i fëmijëve të komunitetit rom

Fëmijët e komunitetit rom vuajnë nga përjashtimi dhe mospërfitimi nga shërbimet e mirëqënies sociale. Fëmijët e këtij komuniteti në ndryshim nga fëmijët e tjerë, për shkaqe ekonomike, futen në rrethin e punëve shfrytëzuese dhe jashtë kapaciteteve të tyre në një moshë shumë të hershme.

Mundësitë e kufizuara ekonomike bëhen një pengesë për frekuentimin e vazhdueshëm të shkollës, përfitimin nga shërbimet shëndetësore etj. Të gjitha këto barrierë krijojnë vështirësi në zhvillimin e kapacitetit intelektual të fëmijëve. Në kushtet e një mentaliteti të tillë, fëmijët futen në një rreth vicioz, në të cilin ndodhen shumë breza. Fëmijët e paarsimuar, pa kujdes shëndetësor, kanë një jetë jopremtuese për të dalë nga vorbullat e varfërisë. Ndaj anëtarët e këtij komuniteti, e kanë të vështirë të fitojnë një vend pune pa kualifikimin e duhur.

Nga takimet e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve Fier në zonat ku ka komunitet rom, rezulton se në zonat ku komuniteti rom jeton i përzier me maxhorancën, fëmijët e kanë më të lehtë procesin e integritimit në jetën sociale. Problemet e mospjesëmarrjes, përjashtimit dhe mospërfitimit të fëmijëve rom nga fushat e mirëqënies sociale lidhen edhe me mosregjistrimin civil të tyre, si edhe me punësimin në moshë të vogël në punë të renda. Komuniteti rom ka kapacitete të ulëta për të ushtruar të drejtën e pjesëmarrjes, kjo sepse ata nuk janë të fuqizuar për t'i kërkuar të drejtat e tyre në institucionet përkatëse.

Roli dhe kontributi i Shoqërisë civile në qarkun Fier

Kontributi i shoqërisë civile në integrimin social të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptianë, është shumë i rëndësishëm. Projektet e implementuara në qarkun Fier nga OJF të ndryshme synojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptianë. Në qarkun Fier ka disa OJF, të cilat kanë ofruar dhe ofrojnë shërbime dhe kontribute për fëmijët e këtij komuniteti, si: Shoqata "Amaro Drom", Shoqata "Roma Aktiv Albania", Shoqata "Rromani Baxt Albania", Shoqata e Romëve Lushnje, Shoqata e Egjiptianëve Lushnje, Instituti i Kulturës Rome, UNDP, Terre des hommes.

Këto OJF nëpërmjet shërbimeve dhe projekteve të tyre kanë ofruar shërbime në disa drejtime, arsimore, shëndetësore, psikologjike, kulturore, informuese, ndërgjegjësuere, fuqizim të komunitetit, kanalizime, strehime etj. Të gjitha llojet e shërbimeve të ofruara në bashkëpunim me institucionet publike, kanë pasur në fokus interesin më të lartë të popullatës rome dhe egjiptiane. Bashkëpunimi i ngushtë midis institucioneve publike dhe shoqërisë civile është mënyra më e mirë për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të vlefshme.

IV. Gjetjet dhe konkluzionet

- Ø **Komuniteti rom karakterizohet si "lëvizës",** për rrjedhojë ky komunitet ruan më tepër vlerat/ traditat/ kulturën e vet dhe e ka më të vështirë procesin e integritimit në jetën sociale. Në krahasim me komunitetin rom, **komuniteti egjiptianë karakterizohet si më i qëndrueshëm,** për rrjedhojë ata e kanë më të vështirë të ruajnë traditat, vlerat e tyre duke u adaptuar më lehtë me vlerat e maxhorancës. Në këto kushte fëmijët e komunitetit egjiptianë janë më të integruar sesa fëmijët e komunitetit rom.
- Ø Në zonat/ lagjet/ fshatrat ku komuniteti rom jeton i përzier me pjesën tjetër të popullsisë, **proçesi i integritimit** është lehtësisht më i realizueshëm. Ndërsa në zonat ku

komuniteti rom jeton i veçuar nga pjesa tjetër e popullsisë, është shumë i vështirë integrimi i tyre.

- Ø Një problem madhor i pjesëtarëve të komunitetit rom është mosrregjistrimi i tyre në gjendjen civile. Për arsye të ndryshme, mosrregjistrimi civil i prindërve dhe i fëmijëve të tyre, sjell përjashtimin nga shërbimet e mirëqënies sociale, si edhe të shërbimeve publike. Për rrjedhojë sipas ligjit nr. 9355 “Për Ndhmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, familjet e parregjistruara në gjendjen civile **nuk përfitojnë/ trajtohen nga skemat e Ndhmës Ekonomike.**
- Ø **118 familje rome me fëmijë 0-18 vjeç** në Qarkun Fier përfitojnë nga skemat e ndihmës ekonomike në vitin 2012. Në krahasim me vitin 2011, numri i familjeve rome që marrin ndihmë ekonomike me fëmijë 0-18 vjeç ka ardhur *duke u rritur me 9 familje* nga 109 familje në vitin 2011 në 118 familje në vitin 2012. Ndërkohë në shumë njësi vendore të rrethit Fier dhe Lushnje, në të cilat ka një numër të lartë të komunitetit rom, nuk ka ndonjë familje të komunitetit rom që trajtohet me ndihmë ekonomike. Gjithashtu Komuna Topojë dhe Komuna Mbrostar në Fier, që kanë komunitet rom janë të përjashtuara nga skema e ndihmës ekonomike.
- Ø **Gjendja e vështirë ekonomike** i detyron prindërit e fëmijëve të komunitetit rom, që t’i shfrytëzojnë fëmijët e tyre si një mjet fitimprurës. Për rrjedhojë fëmijët lypin, shesin kanaçe, bajame, paketa etj duke u bërë pre e sjelljeve negative të shoqërisë.
- Ø **Në zonat ku jeton komuniteti rom**, sidomos në lagjet ku ata janë të veçuar nga maxhoranca **ka mungesa në kanalizimin e ujit të pijshëm.** UNDP nëpërmjet programit “Fuqizimi i Komuniteteve vulnerabël në Shqipëri” ka bërë kanalizime në një pjesë të lagjeve ku jeton ky komunitet.
- Ø Në ciklet e ndryshme të sistemit arsimor (çerdhe, kopsht, arsimi i detyruar i ulët dhe i lartë, arsimi i mesëm) evidentohet një **shkallë e ulët e rregjistrimit në arsim** e fëmijëve të komunitetit rom.
- Ø Anëtarët e komunitetit rom nuk i kushtojnë një vëmendje të veçantë shërbimeve shëndetësore. Meqënëse një problem madhor i këtij komuniteti është mosrregjistrimi civil, është e **pamundur marrja e shërbimeve shëndetësore** të përshtatshme.
- Ø DAR Fier zbaton një Plan vjetor të veprimit për fëmijët rom, në të cilin janë planifikuar aktivitetet për fëmijët e komunitetit rom dhe afatet kohore të realizimit të tyre.

V.Rekomandime

- Ø Rregjistrimi civil i anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptianë në Qarkun Fier. Ky rregjistrim duhet të sjell edhe evidenca të sakta të numrit të popullsisë sipas grupmoshave, të familjeve, të shtëpive si edhe të fëmijëve.
- Ø Rifreskimi i hartëzimit të lokalitetit të komunitetit rom dhe egjiptianë në Qarkun Fier si dhe në rang kombëtar.
- Ø Përmirësimi i kushteve mjedisore dhe infrastrukturore të këtyre komuniteteve me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës për fëmijët.
- Ø Vazhdimi dhe rritja e investimeve dhe projekteve në ndihmë të nevojave të komunitetit rom dhe egjiptianë.
- Ø Zbatimi i Planit të Veprimit rajonal 2013-2015 për fëmijët në përgjithësi dhe për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptianë në veçanti. Ky plan duhet të reflektojë

nevojat aktuale të këtij komuniteti si dhe të pasqyrojaë mjetet/ instrumentat/ metodat dhe mekanizmat përgjegjës.

- Ø Përforsimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet mekanizmave institucional publik dhe jopublik në interes të mirëqënies së fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptianë.
- Ø Ofrimi i kurseve profesionale dhe trajnuese nga Qendra e formimit profesional. Për të matur efektivitetin e kësaj qendre, është e rëndësishme krahasimi i shifrave mes anëtarëve të komunitetit rom që janë të rregjistruar në këto kurse dhe e anëtarëve që arrijnë të punësohen pas ndjekjes së tyre.
- Ø Ofrimi i ndihmës profesionale për menaxhimin e rasteve dhe problemeve specifike nëpërmjet takimeve të grupet teknike në nivel rajonal.
- Ø Punë me ndryshimin e sistemit (pushteti lokal). Vendosja e kuotave ose fondeve specifike për këtë komunitet nga ana e njësisë vendore që kanë në përbërje të tyre rom dhe egjiptianë.
- Ø Rritja e nivelit të frekuentimit të fëmijëve rom e egjiptianë në ciklet e ndryshme të sistemit arsimor: çerdhe, kopsht, i detyrueshëm (cikli i ulët dhe i lartë) dhe të mesëm.
- Ø Ndryshime në kurrikulat dhe programet mësimore për pasqyrimin në to të kulturës, historisë romë dhe të përfitimeve që vijnë nga arsimimi në jetën e mëvonshme.
- Ø Përfshirja e prindërve në arsim nëpërmjet metodave të prindërimit të mirë dhe të investimit në fëmijërinë e hershme.

Ø Bibliografia

- OSCE (18.09.2003) “*Strategjia Kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom*”, Shtëpia Botuese Pegi.
- Udhëzim nr. 06, datë 29.03.2006, “*Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindje*”.
- Këshilli i Ministrave Nr.633, Fletore Zyrtare, 18 Shtator 2003.
- VKM nr 563, datë 12.8.2005, “*Për përcaktimin e përgjegjësi të qarkut dhe shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore*”.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989. Hyrë në fuqi: 2 Shtator 1990.
- MPCSSHB, UNDP, United Nationa Albania, Dekada e Përfshirjes së Romëve, Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015
- Monitorimi nga shoqëria civile i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Dekadës Rome në vitin 2012 në Shqipëri.
- Qendra e Zhvillimeve Humane, UNICEF, Save the Children, Raport Studimor (2007) “*Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri*”, Tiranë.
- UNDP, CESS (2012) “*Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri*”, Tiranë.
- Avokati i Popullit (2009) Raport i veçantë nr 4 “*Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit Rom në Shqipëri*”, Tiranë.
- Bashkia Lezhë (2013) “*Plani Vendor i Veprimit i Bashkisë Lezhë për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2013-2015*”.
- FBSH, ARSIS, FPGSH, Raport Studimor “*Mbi situatën e romëve që jetojnë e punojnë në vendshkarkimin e mbeturinave në sharrë*”, Tiranë.
- CESS (2012), “*Mapping Children Roma in Albania*”, Tiranë.
- Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.
- www.sidalbania.org

Të dhëna nga Institucionet dhe takimet:

- Të dhëna nga Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier, Prill 2012
- Të dhëna nga Shërbimi Social Shtetëror, zyra rajonale Fier, Evidencat Dhjetor 2012
- Blerina Zoto, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, 4 Dhjetor 2014
- Të dhënat janë mbledhur nga punonjësj e NJMF në Komunën Fiershegan Lushnje, Dhjetor 2013
- Takimet e realizuara në Qendra Shëndetësore/ Ambulancat në muajt Dhjetor 2013- Janar 2014
- Takim me mjeken e Ambulancës Hamil në fshatin Baltëz Dërmenas, 18 Dhjetor 2013
- Takim me maminë e Ambulancës Seman i ri në Komunën Topojë Fier, 10 Janar 2014
- Takim me drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare Llukan Sako, fshati Seman i ri, Komuna Topojë Fier, 10 Janar 2014
- Takim me mjeken e Ambulancës Zhamë në Komunën Dushk Lushnje, 29 Janar 2014

- Shtojca a
Pyetësor drejtuar të gjitha njësive vendore në qarkun Fier (Nëntor- Dhjetor 2013)

Njësia vendore _____

Në rast se në njësinë tuaj vendore ka komunitet rom, ju lutem plotësoni me të dhëna për vitin 2012:

1. Statistika për komunitetin rom në njësinë tuaj vendore:

- Numri i familjeve të komunitetit rom _____
- Numri i popullsisë rome _____
- Numri i fëmijëve (0-18 vjeç) të komunitetit rom _____

2. Të dhëna mbi kontekstin dhe vendodhjen gjeografike, situatën ekonomike, problemet sociale, faktorët institucional të komunitetit rom në njësinë tuaj vendore. Cilat janë efektet që këta faktorë kanë në gjendjen e fëmijëve rom?

3. Cilat janë **nevojat imediate** për fëmijët e komunitetit rom?

4. **Arsimimi** i fëmijëve rom:

Numri i fëmijëve rom në moshë parashkollore (3-6 vjeç) _____

Numri i fëmijëve rom që ndjekin arsimin parashkollorë (3-6 vjeç) _____

Numri i fëmijëve rom 6-15 vjeç _____

Numri i fëmijëve rom 6-15 vjeç që ndjekin arsimin e detyruar 9-vjeçar _____

Numri i fëmijëve rom 15-18 vjeç _____

Numri i fëmijëve rom 15-18 vjeç që ndjekin arsimin e mesëm _____

5. Si paraqitet **gjendja shëndetësore** e fëmijëve rom _____

Shkalla e vaksinimit _____

A kanë librezat shëndeti? _____

Shtojca b**Lista e Komunave, Bashkive, fshatrave ku banon komuniteti Rom në qarkun Fier**

| Nr. | Njësia vendore | Administratorët social |
|------------|-------------------------------------|-------------------------------|
| | Rrethi Fier | ---- |
| 1 | Komuna Qendër, Fshati Rom | Rrapi Vogli |
| 2 | Komuna Qendër, Fshati Fermë Çlirim | Rrapi Vogli |
| 3 | Komuna Dërmenas, Fshati Baltëz | Fatos Koçi |
| 4 | Komuna Dërmenas, Fshati Povelçe | Fatos Koçi |
| 5 | Komuna Levan | Xheksila Hamataj |
| 6 | Komuna Topojë, Fshati Sektor Seman | Jonel Mine |
| 7 | Bashkia Roskovec | Alda Gjata |
| 8 | Komuna Mbrostar Ura | Mustafa Hejbeja |
| | Rrethi Lushnje | ---- |
| 1 | Komuna Grabian | Besim Shuka |
| 2 | Komuna Tërbuf, Fshati Çermë | Shkëlqim Snalla |
| 3 | Komuna Tërbuf, Fshati Shën e Premte | Shkëlqim Snalla |
| 4 | Komuna Dushk, Fshati Gramsh | Liza Tabaku |
| 5 | Komuna Dushk, Fshati Zhamë | Liza Tabaku |
| 6 | Komuna Golem, Fshati Plug | Rovena Hajdari |
| 7 | Bashkia Lushnje, Lagja Savër | Valbona Myzeqari |

Shtojca d

Plan vjetor i veprimtimit për fëmijët romë, DAR Fier

| Nr. | Aktivitetet që do të realizohen | Zbatuesi | Afati |
|-----|--|---|--------------------------|
| 1 | Hartimi i hartës sociale të fëmijëve duke përfshirë fëmijët romë, në shkollat me komunitet rom të rrethit Fier. | Drejtoritë e shkollave: Zhupan, Hamil, Levan, Roskovec, mësuesit e ngarkuar nëpër shkolla | Shtator |
| 2 | Takim i përbashkët me përfaqësues të prindërve të komunitetit rom, që janë përvoja pozitive në shkollë, përfaqësues të komunave përkatëse, mësuesve të shkollave, përfaqësues të OJF-ve të interesuara, për identifikimin e problemeve më emergjente të ndjekjes së shkollës, të fëmijëve të këtij komuniteti. | DAR, shkollat përkatëse dhe aktorë të interesuar për këtë çështje | Tetor |
| 3 | Takime në familjet rome, mbështetur nga përfaqësues të këtij komuniteti, për të nxitur frekuentimin e kopshteve dhe shkollave prej fëmijëve që janë në moshën përkatëse. | DAR, shkollat OJF, pushtet lokal | Vazhdimisht |
| 4 | Aktivitete promovuese, argëtuese, për të drejtat e fëmijëve në shkolla, sipas planeve individuale të shkollave, me rastin e Ditës së të Drejtave të tyre. | Drejtoritë e shkollave, DAR Fier | Nëntor |
| 5 | Referim i rasteve me probleme sociale dhe psikologjike, nga mësues, përfaqësues të komunitetit etj, të NJDF, për mbështetje, ndjekje të mëtejshme, bashkërendim i punës me partnerë të tjerë. | DAR, NJDF në komuna, OJF. | Vazhdimisht |
| 6 | Veprimtari për promovimin e traditës, kuzhinës rome me rastin e Ditës së Romëve, duke u mbështetur në planet individuale të shkollave. | Shkollat 9- vjeçare Zhupan, Hamil, Levan, Roskovec, kopshtet përkatëse | Prill |
| 7 | Grafik takimesh të organizuara me prindër të fëmijëve dhe ata romë, për një prindërim të mirë, mbështetje psiko-emocionale, evidentim i shembujve pozitivë të fëmijëve romë në frekuentimin e shkollës. | DAR, drejtoritë e shkollave | Shkurt- Mars- Prill- Maj |